



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 17     Datë 10. 04 . 2017

**“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “CR POWER 2016” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 4219/7, datë 28.07.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “**CR POWER 2016” SH.P.K** me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

**V e n d o s i :**

1- Miratimin e kërkesës së subjektit “**“CR POWER 2016” sh.p.k** me administrator Z.Avenir ALLUSHI , për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Thatë**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës , për prodhim energjie elektrike në Fushë- Bulqizë,Njësia Administrative Fushë- Bulqizë ,Bashkia Bulqizë , Qarku Dibër. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , objekti HEC TEZALLE 2 do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes :            X – 44 40 250 ;    Y – 45 97 106 ;    Z – + 841.91m  
Koordinatat e godinës së centralit:        X – 44 40 804;    Y – 45 98 006;    Z – + 656.15 m  
Koordinatat e pikes së shkarkimit :        X – 44 40 804;    Y – 45 98 006;    Z – + 656.15 m  
Prurja mesatare e përroit: Qmes= 0.136 m<sup>3</sup>/sek;  
Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0.25 m<sup>3</sup>/sek;  
Prurja ekologjike:            Q ekol= 0.027 m<sup>3</sup>/sek;  
Prurja që shkarkohet:        Q= 0.25 m<sup>3</sup>/sek.

2- Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujqë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETARI**  
**Martin PLLUMBI**



**KRYETARI**  
**Paulin RADOVANI**